



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVA
KOMISIONI I PAVARUR I MEDIAVE
NEZAVISNA KOMISIJA ZA MEDIJE
INDEPENDENT MEDIA COMMISSION



Dasma TV
Nehat Fejza
Drejtor
Prishtinë

VENDIM

**Lidhur me Rastin Nr. 2023/156 – Komisioni i Pavarur i Mediave (KPM) për Dasma TV
(Pala Përgjegjëse)**

Faktet

1. Pala përgjegjëse me datën 19 tetor 2010, është pajisur me licencë të KPM-së me seli në Prishtinë. Me marrjen e Licencës Pala përgjegjëse është obliguar që të respektojë Ligjin e KPM-së, Kushtet dhe Termet e Përgjithshme të Licencës si dhe aktet tjera nënligjore të nxjerra nga KPM.
2. KPM me datën 17 dhjetor 2021 ka nxjerrë Rregulloren KPM-2021/01 për Ofruesit e Shërbimeve Mediale Audio dhe Audiovizuale. Me këtë Rregullore përcaktohen kriteret, të drejtat dhe obligimet për ofruesit e shërbimeve mediale, pa marrë parasysh mënyrën e transmetimit në Republikën e Kosovës, me qëllim të garantimit të mbrojtjes së pluralizmit medial dhe interesit publik, si dhe të mundësohet garë e drejt dhe e barabartë në tregun medial në Republikën e Kosovës.
3. Me datë 19 tetor 2020, Komisioni i KPM-së mori Vendim për ripërtëritjen të licencës të Palës përgjegjëse për të vepruar si ofrues i shërbimeve mediale, përmes operatorëve të shpërndarjes në Republikën e Kosovës.
4. KPM duke u bazuar në faktin se Pala përgjegjëse ka bërë ndryshime në pronësi me datën 1 nëntor 2022, i ka dërguar shkresë përmes të cilës e ka njoftuar për shkeljet e bëra lidhur me ndryshimin e pronësisë pa miratim paraprak me shkrim nga KPM-ja.
5. Pala përgjegjëse me datën 8 maj 2023, ka dorëzuar në KPM kërkesën për ndryshim të pronësisë ku në certifikatën e regjistrimit të biznesit ka ndryshime, fillimisht është ndryshuar lloji i biznesit nga NSH Dasma TV në Dasma TV SHPK me numër unik identifikues 810899081, ku figuron edhe numri i më parshëm i biznesit 70669188 si dhe ndryshimin e pronarit si person fizik nga z. Nehat Fejza dhe kalimin tek z. Ramiz Vitia dhe Misret Beqiri.
6. KPM, bazuar në Raportin e departamentit të licencimit të datës 27 tetor 2023, ka gjetur se Pala përgjegjëse ka bërë ndryshim të pronësisë në certifikatën e regjistrimit të biznesit pa miratim

paraparak të KPM-së, duke vepruar kështu në kundërshtim me Ligjin e KPM-së, Kushtet dhe Termet e Përgjithshme të Licencës dhe Rregulloren KPM-2021/01 për Ofruesit e Shërbimeve Mediale Audio dhe Audiovizuale.

Analiza ligjore

7. Komisioni bazuar në të gjitha faktet dhe analizat e lartpërmendura konstaton se Pala përgjegjëse ka vepruar në kundërshtim me Ligjin e KPM-së, Kushteve dhe Termeve të Përgjithshme të Licencës, dhe Rregullores KPM-2021/01 për Ofruesit e Shërbimeve Mediale Audio dhe Audiovizuale.

8. Pala përgjegjëse ka vepruar në kundërshtim me nenin 21 paragrafi 3, i Ligjit të KPM-së, i cili përcakton se:

“Licencat nuk mund të shfrytëzohen dhe barten pa autorizimin dhe pa aprovimin paraparak me shkrim të KPM-së.”.

9. Në kundërshtim me nenin 18, të Rregullores për Ofruesit e Shërbimeve Mediale Audio dhe Audiovizuale KPM – 2021/01, i cili përcakton se:

“ Licencat nuk mund të shfrytëzohen dhe transferohen pa autorizim dhe pa aprovim paraparak me shkrim nga KPM”.

10. Në kundërshtim me nenin 5, paragrafin 5.2, dhe paragrafin 5.3, të Kushteve dhe Termeve të Përgjithshme të Licencës së KPM-së, i cili përcakton se:

5.2 “Transferimi ose Dorëzimi i Licencës: I licencuari nuk mund të transferojë ose dorëzojë këtë licencë pa miratimin paraparak me shkrim të KPM-së. Çdo ndryshim në pronësi që kap më shumë se 10% të aksioneve të interesave ose ato që ndikojnë shumë në kontrollin e të licencuarit do të kërkojnë paraparakisht miratim me shkrim nga ana e KPM-së.”

5.3 “Leja për transferimin: KPM do të lejojë transferimin e licencës vetëm kur ajo sigurohet që individi ose organizata të cilët propozohen që t’iu transferohet licenca plotësohen standardet e KPM-së për t’iu dhënë ajo licencë. Në bazë të mandatit të saj, KPM mund të kërkojë që çdo transferim i një licence tek një pronësi e re t’i nënshtrohet procedurave të rregullta për të siguruar që një transferim i tillë është në pajtueshmëri me të gjitha rregulloret e KPM-së.”

11. KPM bazuar në Raportin e departamentit të Licencimit ka konstatuar se Pala përgjegjëse, ka bërë ndryshim të pronësisë në certifikatën e regjistrimit të biznesit pa miratim paraparak të KPM-së.

12. KPM bazuar në faktet e lartpërmendura ka konstatuar se Pala përgjegjëse ka vepruar në kundërshtim me nenin 21 paragrafi 3, të Ligjit të KPM-së, nenit 18, të Rregullores për Ofruesit


e Shërbimeve Mediale Audio dhe Audiovizuale KPM-2021/01, nenin 5 paragrafin 2, dhe paragrafin 3 të Kushteve dhe Termeve të Përgjithshme të Licencës së KPM-së, duke bërë ndryshim të pronësisë në certifikatën e regjistrimit të biznesit pa miratim paraprak të KPM-së.

Vendim

13. Pala përgjegjëse të sanksionohet me **Gjobë** në shumën prej dymijë (2.000) euro në pajtim me 30 paragrafi 1.3 të Ligjit të KPM-së, për shkeljet të vazhdueshme të nenit 21, paragrafin 3, të Ligjit të KPM-së, nenin 18 Rregullores për Ofruesit e shërbimeve Mediale Audio dhe Audiovizuale-KPM-2021/01, nenit 5, paragrafin 5.2, dhe paragrafin 5.3 të Kushteve dhe Termeve të Përgjithshme të Licencës.

E drejta për ankesë

14. Ankesat i parashtrohen Bordit për Ankesa brenda tridhjetë (30) ditësh nga pranimi i vendimit të KPM-së në pajtim me nenin 29, paragrafi 5, të Ligjit të KPM-së. Ankesa bëhet me shkrim dhe duhet të përcillet me dokumente ose dëshmi që mund të kërkohen nga Bordi i Ankesave në pajtim me nenin 42, paragrafi 2, të Ligjit të KPM-së.
15. Bordi për Ankesa do t'i merr parasysh vetëm ankesat e bazuara në informacione ligjrisht relevante të cilat nuk ishin të disponueshme në kohën e marrjes së vendimit të KPM-së, apo të bazuara në mundësi se ekzistonte gabim procedural dhe material i bërë nga ana e KPM-së gjatë marrjes së vendimit.



Jeton MEHMETI
Kryetar

24.11.2023

Datë

